

V E N D I M
Nr.206, datë 16.5.1994

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.137, DATË
31.3.1994 “PËR DISA NDRYSHIME NË ÇMIMET E ARTIKUJVE ENERGJETIKË”**

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.137, datë 31.3.1994, në pikën 2, shkronja “b”, paragrafi i tretë, pas fjalëve “të prodhimit të ujit të pijshëm” shtohen fjalët “dega e qymyreve”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi